



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 454/2 Prot

Tiranë, më 09.07.2021

V E N D I M

Nr.93, datë 09.07.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses ***, nëpunëse civile në pozicionin “Specialist në Sektorin e Kontabilizimit të të Ardhurave”, në Bashkinë Devoll.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bazuar në rregullat e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së masës disiplinore “Vërejtje” ndaj nëpunëses *****,

Vërej se:

Nëpunësja *****, nëpërmjet një kërkesë, paraqitur dhe protokolluar pranë Komisionerit, me nr. 454 prot., datë 06.04.2021, ka ngritur disa pretendime për paligjshmëri të aktit administrativ nr. 21 (1006/4 prot.) datë 25.03.2021 të eprorit direkt, në lidhje me marrjen ndaj saj, të masës disiplinore “Vërejtje”.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se nëpunësja në fjalë, në datën 11.03.2021, ora 13.45, për arsye personale dhe me lejen e eprorit direkt, është larguar nga institucioni. Gjatë kësaj kohe, meqënëse është parë nga titullari i institucionit, në selinë e një force politike, duke dyshuar që po kryente veprimin jo të ligjshme, Kryetari i Bashkisë Devoll, ka

kërkuar menjëherë të kontrollohet prezenca në punë e punonjësve të Bashkisë dhe pasi ka konstatuar zyrtarisht mungësën e saj, ka kërkuar vënien para përgjegjësive disiplinore.

Për këtë arsye, ankuesja kërkon ndërhyrjen e Komisionerit, pasi sipas kërkesë/ankesës paraqitur prej saj, pretendohet se trajtimi sa më sipër, është veprim i paligjshëm dhe diskriminues.

Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm për verifikimin e ligjshmërisë së kësaj ecurie disiplinore, dërguar prej Bashkisë Devoll, me e-mail të datës 7 Maj 2021, rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Nëpunësja ***** është nëpunëse civile e konfirmuar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Kontabilizimit të të Ardhurave*”, në Bashkinë Devoll dhe në datën 11.03.2021, pretendon se ka kërkuar leje (15-20 min) nga eprori i saj direkt, për arsye familjare, lëvizje e cila, sidoqoftë, nuk rezultoi e regjistruar në dokumentacionin përkatës, si lëvizje jashtë institucionit (*pranuar kjo dhe në procesverbalin e seancës dëgjimore, mbajtur për këtë rast*).

Mosmarrëveshja, e lindur në këtë rast, ka lidhje me shkakun se, në kohën e lejes së kërkuar, nëpunësja është parë që është takuar me persona pjesëmarrës në fushatën elektorale të njëjës prej forcave politike (*konstatuar nga titullari i institucionit, i cili ka urdhëruar menjëherë, kontrollin e prezencës në punë të punonjësve të Bashkisë Devoll; -Kjo vërtetohet me akt konstatimin e mbajtur nga grupi i monitorimit dhe libri i hyrje daljeve të institucionit*).

Me konstatimin e mosprezencës në punë të nëpunëses në fjalë, titullari i institucionit i ka kërkuar eprorit direkt fillimin e ecurisë disiplinore, i cili pasi ka bërë një vlerësim paraprak të situatës, me shkresën nr. 1006 prot., datë 10.03.2021 “*Vlerësim paraprak i shkeljes disiplinore të pretenduar dhe klasifikim të saj*”, ka iniciuar fillimin e procedimit disiplinor.

Me shkresën nr. 1006/1 prot., datë 10.03.2021 “*Njoftim për fillim ecurie disiplinore*”, ka njoftuar nëpunësen ***** për fillimin e ecurisë disiplinore. Në këtë akt, në zbatim të pikës 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, është caktuar edhe data për dëgjimin e pretendimeve të nëpunëses së proceduar.

Seanca dëgjimore për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj nëpunëses në fjalë, është zhvilluar në datën 24.03.2021, në prezencë të eprorit, në ambientet e institucionit. Gjithashtu ankuesja ka paraqitur edhe pretendimet e saj dhe ka kundërshtuar në lidhje me çështjet që janë parashtruar në këtë seancë. (*Akti nr. 1006/3 datë 24.03.2021, procesverbali i mbajtur*).

Eprori direkt pasi ka vlerësuar edhe njëherë situatën, ka arritur në përfundimin që shkelja e konstatuar ishte e një natyre të lehtë, për faktin se koha që ishte larguar punonjësja nga posti i punës ishte e shkurtër, por ai e konsideron të rëndë arsyen dhe qëllimin e lëvizjes (*pavarësisht se është e paqartë si situatë*), pasi sipas tij, kjo bie ndesh me përcaktimin e pikës 1, të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe me rregulloren e grupit të monitorimit, (*urdhëri nr. 101 datë 24.02.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësit civil gjatë fushatës zgjedhore*), të ngritur për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civil gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare për Kuvendin e Shqipërisë, Prill 2021.

Në këto kushte me aktin nr. 21 (1006/4 prot), datë 25.03.2021 “*Për dhënie mase disiplinore*”, eprori direkt pasi ka përmbyllur hetimin administrativ të rastit dhe pasi ka vlerësuar çështjen në përputhje me rrethanat konkrete, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*vërejtje*”.

Ky është një akt i ligjshëm, i marrë në ushtrim të rregullt të diskrecionit, nga ana e eprorit direkt dhe konfirmuar nga drejtuesi i bashkisë, pasi është kryer procedura e rregullt administrative për trajtimin e një ecurie disiplinore, siç është parashikuar në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”.

Nga sa më sipër, nisur nga përmbajtja e akteve ligjore e nënligjore, në të cilat materializohet procedura disiplinore, provohet se, nga pikëpamja procedurale, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni me shkrim dhe dëgjimit të pretendimeve të personit të proceduar disiplinorisht, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të argumentuar nga organi disiplinor kompetent.

Përfundimisht, nisur nga gjithë sa u tha më sipër, konkludohet se në rastin konkret nuk ka vend për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit administrativ dhe se çështja duhet të arkivohet, pasi vlerësohet se procedura e ndjekur dhe veprimet e kryera nga e njësisë përgjegjëse të bashkisë Devoll, janë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr.21 (1006/4 prot), datë 25.03.2021 “Për dhënie mase disiplinore vërejtje”, të eprorit direkt, ndaj nëpunëses *****, mbajtëse e pozicionit “Specialist në Sektorin e Kontabilizimit të të Ardhurave”, në Bashkinë Devoll.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Devoll dhe ankuesja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha